

VENDIM
Nr.203, datë 20.12.2010

**PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO
EAGLE” SUBJEKTIT “DYNAMICS SOUND” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënie e licencave për transmetime televizive dhe radion FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.889, datë 6.11.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “Dynamics Sound” sh.p.k. për radion vendore private “Radio Eagle”, sipas licencës nr.051/FML, në qarqet Fier-Vlorë.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati